



GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES SË NXËNËSVE
NË FUND TË CIKLIT TË TRETË TË SHKOLLËS FILLORE

MAJ, VITIT MËSIMOR 2014/2015

UDHËZIM

Koha për zgjidhjen e testit është **70 minuta**.

Mos e hapni testin dhe mos filloni t'i zgjidhni detyrat derisa të mos ju japë leje mësimdhënësi kujdestar.

Testi **DUHET** të jetë i shkruar me laps kimik ose me stilolaps.

Shkruani lexueshëm me shkronja dore.

Nëse shkruani me shkronja shtypi, theksojeni shkronjën e madhe aty ku duhet të jetë. Respekto rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore. Nëse mendon se ke gabuar me rastin e zgjidhjes së detyrës, vendos një vijë të kryqëzuar (X) mbi të dhe zgjidhe përsëri.

Nuk guxon të përdorësh korrektorin.

Detyrat nuk e ke për detyrë t'i zgjidhësh me rend ashtu siç janë dhënë në test.

Nëse e përfundon punën më parë, kontrolloji edhe një herë zgjidhjet tua.

Detyra do të vlerësohet me zero (0) pikë nëse:

- është e pasaktë
- është e palexueshme dhe nuk është shkruar qartë përgjigjja
- është e shkruar me laps të thjeshtë
- është shkruar ose qarkuar edhe përgjigjja e saktë dhe e pasaktë

ME FAT!

SHIFRA E NXËNËSIT

FAQJA E ZBRAZËT

Shikoje tabelën dhe përgjigju në pyetjen 1 dhe 2.

Struktura e popullatës sipas gjinisë nëpër komuna – numri dhe struktura sipas regjistrimit të vitit 2011.

(Burimi: MONSTAT – Enti për Statistika)

	POPULLATA			STRUKTURA SIPAS GJINISË %	
	Gjithsej	Mashkull	Femër	Mashkull	Femër
MALI I ZI /	620029	306236	313793	49.39	50.61
MONTENEGRO	5071	2614	2457	51.55	48.45
Andrievicë	42048	20670	21378	49.16	50.84
Tivar	33970	17087	16883	50.30	49.70
Beran	46051	23204	22847	50.39	49.61
Biello Pole	19218	9224	9994	48.00	52.00
Budvë	16657	8031	8626	48.21	51.79
Cetinë	18472	9704	8768	52.53	47.47
Danillovgrad	30864	14990	15874	48.57	51.43
Herceg Novi	8380	4229	4151	50.47	49.53
Kollashin	22601	10837	11764	47.95	52.05
Kotor	8622	4352	4270	50.48	49.52
Mojkovac	72443	35751	36692	49.35	50.65
Nikshiq	13108	6664	6444	50.84	49.16
Plavë	30786	15138	15648	49.17	50.83
Plevle	3246	1666	1580	51.32	48.68
Podgoricë	185937	90614	95323	48.73	51.27
Rozhajë	22964	11776	11188	51.28	48.72
Shavnik	2070	1071	991	51.74	48.26
Tivat	14031	6903	7128	49.20	50.80
Ulqin	19921	9938	9983	49.89	50.11
Zhablak	3569	1773	1796	49.68	50.32

- 1.** Shkruaje institucionin i cili merret me grumbullimin dhe rregullimin e të dhënave statistikore.

1 pikë

2. Cilat janë dy komunat që kanë më së paku dhe më së shumti femra?

1. Plluzhina dhe Nikshiqi
2. Plluzhina dhe Podgorica
3. Shavniku dhe Podgorica
4. Andrievica dhe Biello Pola

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë.

1 pikë

Tabela në vazhdim tregon sa e përdor internetin shoqëria malazeze si medium. Duke u bazuar në përmbajtjen e saj zgjidhe detyrën 3.

QASJE NË INTERNET TE SHTËPIA

Tipi i vendbanimit	Veriu	Qendra	Jugu	Podgorica	Mali i Zi
Qyteti	52,0%	67,3%	63,7%	65,9%	63,1%
Të tjerat	28,8%	60,0%	51,3%	41,7%	41,5%
Gjithsej	39,5%	65,4%	58,8%	62,4%	55,8%

(Përgatitur sipas Kumtesës së Entit për Statistika, numër 281 të datës 01.11.2013)

3. A) Cili rajon në Mal të Zi ka mundësitë më të mira për shfrytëzimin e internetit:

1. Podgorica
2. Rajoni i jugut
3. Rajoni i veriut
4. Rajoni qendror

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë.

B) Sa është përqindja mesatare e amvisërive të Malit të Zi që kanë qasje në internet te shtëpia.

C) Cili rajon ndodhet nën këtë përqindje?

3 pikë

4. Shkruaje përemrin vetor ose trajtën e shkurtër të duhur në fjalitë:

Dëshiroj nga (ju/juve) _____ të më lini rehat.

Gjithashtu edhe (ne/neve) _____ do të na vijë keq po të largohesh.

Ai është i rëndësishëm për (ne/neve) _____.

Njerëzve (u/ju) _____ kam ofruar shumë ndihmë.

2 pikë

5. Shokët dhe shoqet e klasës organizojnë festimin me rastin e përfundimit të shkollës fillore. Kanë vendosur që t'i ftojnë shokët dhe shoqet nga klasat tjera (ose nga shkollat tjera). Shkruaje ftesën në emër të klasës tënde.

3 pikë

Lexo fragmentin e dhënë dhe pastaj përgjigju në pyetjet 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12.

KUMBULLA PËRTEJ MURIT

Kjo i ndodhi LecGurëmollës ndër të parat lirime vere që i erdhi me kalue në Shkodër mbas dhetëvjesh banimi ndër shkolla të përjashtëshme.

Nji ditë korriku i takoi m'undalunpermjesditë te nana e dajës. Kah mbarimi i zhegut, nësa tjerët flejshin ende, zbriti poshtë n' oborr e mbandej hyni në kopësht mbas shtëpije.

S'ishte e para herë, mbas kthimit të tij në Shkodër, që vinte në shtëpi të dajave, por asnji herë s'kishte pasë rasë me shetitë të gjitha skutat ku strukeshin kujtimet ma t' ambla të fminis së largët.

Kopshti, n' at mbasdite të nxehtë, heshte në diell. Ajo heshtje e tij po vlonte me zane të panjohura veçse të lehta e me levizje disi të shutituna. Lëvizje kandrrash e flutrash; zane bletësh e grëthash. Ndihej si një marrje fryme e gjanë bimësh, nji aht i thellbimuertue u përhapun nëpër at heshtimari. Lëshojshin hije anavehardhijat e rrëfatuna në huj te tyne me gjethe stërpikë në gur kali, ndërmjet cilvelavireshin vilet e rrushit ende të bleruna e ende të pashejuna e në midis pemët rrjesht e rrjesht, zerdelija, pjeshka, dardha, molla, ftoj, kumbulla. Asaj hije i jepte ngjyrë të bruzët ari i diellit me freskime plot gjallni. Kumbullat deng me kokrra të pjekuna s'mungojshin aty ne kopësht. Por sytë e Lecit, si të tërhjekun prej njifuqije shortare, kërkuen një kumbull përtej murit.

Ishin dhetë vjet, e ma ndoshta, që s' e shifte at mur. Nji mur i vjetër, jo fort i naltë, i nxim prej kohet, me kërqele gjithkund të rame. Ngjyra e atij murit e bante Lecin me andrrue. S' kishte nji ngjyrë të përçansueme: në te të gjitha ngjyrat ishin te permbledhuna.

Shiu e dielli, tue u rrahë me vjet e vjet, e kishin veshun me një lëmashk, të bruzët ashtu si hijet e gjalla të kopshtit. Në skaj të tij, aty ku përbantekand me një anë tjetër, shtrihej për te e kacavarej dashunishtnjijasmimpym me lule të bardha të çeluna. Ajo lule me njomsi dhe amsim të vet ngushullonteplesin e murit.

Përtej atij muri në njikopësht të huej, me do degë të nalta që zgjateshin edhe këtej, ngrihej një kumbull. Sytë e Lecit e përshëndetën me adhurim. Arsyen e këtij adhurimi as ai qartas s' e kuptonte. Në mjegullimet e kalthëra që mbeshjtjellëshinfinin e tij në mbamendje, ajo kumbull naltohejgjallnisht mbi çdo gja tjetër. Psehin s'e dinte. As nuk përpiqej m' e dijtë. Atij i mjaftonte ajo andje e hollë që, tueshikue kumbullën e huej përtej murit, nga sytë i rrëshqite në shpirt, në të cilin zgjoheshin ndjesina të vjetra e shije të harrueme.

6. Këtë fragment e ka shkruar:

1. ErnestKoliqi
2. KristoFloqi
3. Ndre Mjeda

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë.

1 pikë

7. A) Fragmenti i dhënë është karakteristik për:

1. letërsinë popullore
2. letërsinë artistike

B) Pse? Argumento përgjigjen.

2 pikë

8. Lecitnë kopsht përtej murit i tërheq kujdesin:

1. dardha
2. kumbulla
3. pjeshka
4. zerdelia

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë.

1 pikë

9. Veçoni elementet e sakta dhe të pasakta nga fragmenti duke rrethuar PO pohimet e sakta dhe JO pohimet që nuk janë të sakta.

Ishte hera e dytë që mbas kthimit në Shkodër vinte në shtëpi të dajave.
Nji mur i ri, fort i naltë, i nxim prej kohet me kërqele të bardhë.
Përtej atij muri në një kopësht të huaj ngrihej një kumbull.
Ngjyra e atij muri, jo fort të naltë, e bante Lecin me andrrue.

PO JO
PO JO
PO JO
PO JO

3 pikë

10. Cila figurë stilistike është përdorur në fjalinë: *Kopshti, n' at mbasdite të nxehtë, heshte në diell?*

1. anafora
2. eufemizmi
3. krahasimi
4. personifikimi

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë.

2 pikë

11. Shkruaji në gjuhën standarde fjalët dialektore:

dhjetë vjetsh _____

n' at mbasdite _____

ma t' ëmbra _____

fminissë largët _____

2 pikë

12. Në cilën shkallë është dhënë mbiemri në fillim të fjalisë së mëposhtme?

Nji mur i vjetër, jo fort i naltë, i nxim prej kohet, me kërqele gjithkund të rame.

1 pikë

Lexo fjalitë në vazhdim dhe zhvillo detyrat 13, 14, 15, 16 dhe 17.

Dritat e ditës treten ngadalë **mbi tjegullat e shtëpive** dhe një ngjyrë manushaqe i mbështjell plotësisht. Blerta vazhdonte të lexonte. Ishte mëngjes dhe prej maleve frynte një erë e ëmbël.

13. Shënoje funksionin sintaksor që kryejnë fjalët e nënvizuara në fjalinë e parë.

Drita e ditës _____

mbi tjegullat _____

e shtëpive _____

1 pikë

14. Fjalja e dytë është

1. dëftore
2. pyetëse
3. dëshirore

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë.

1 pikë

15. A) Në cilën mënyrë është përdorur forma foljore të lexonte?

B) Formën e dhënë ktheje në dëftore.

2 pikë

16. A) "Ishte mëngjes dhe prej maleve frynte një erë e ëmbël", është fjali e përbërë:

1. me bashkërenditje
2. me nënrenditje

Rretho numrin para përgjigjes së saktë

B) Cila është lidhëza që e lidhë fjalinë nën A).

2 pikë

17. Cakto rasën e fjalëve në vijim nga fjalitë e dhëna më sipër.

e shtëpive _____

mëngjesi _____

prej maleve _____

e ditës _____

2 pikë	
--------	--

18. Cakto llojin e fjalëve në fjalinë:

Nxënësi i mirë zgjohet herët.

Nxënësi _____

i mirë _____

zgjohet _____

herët _____

2 pikë	
--------	--

19. Shkruaje një hartim prej 80 deri në 100 fjalë, në të cilin do të përshkruash qëndrimin tënd në shkollën fillore. Gjatë shkrimit të hartimit përdori figurat stilistike të cilat do t'i kontribuojnë paraqitjes më të figurshme dhe bindëse të temës së dhënë; hartimin formoje si një tërësi të rrumbullakuar mirë (me hyrje, zhvillim dhe përfundim). Titulloje hartimin.

Kij kujdes për rregullat e drejtshkrimit dhe ato gramatikore. Shkruaj qartë dhe respekto kërkesën për numrin e fjalëve +/- 10% (vlerësohet ai hartim që ka prej 72 deri 110 fjalë; nëse hartimi ka më pak se 72 fjalë, NUK DO TË LEXOHEM, ndërsa pas fjalës së 110-të leximi NDËRPRITET).

- Titulloje hartimin
- Përshkruaje si e ke përjetuar takimin e parë me shkollën, klasën...
- Përshkruaje kujtesën për mësuesin/mësuesen, shokun/shoqen
- Mendo se si ndryshoi kjo me kalimin e kohës dhe si mendon tani për shkollën të cilën po e përfundon

18 pikë	
---------	--

E PLOTËSON KOMISIONI PËR VLERËSIM

Numri i përgjithshëm i pikëve të fituara në test: _____

Nota: _____

KOMISIONI:

VLERËSUESI KRYESOR: _____

Data _____ 2015